



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 2

Prishtinë, më 30.03.2011, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviq, Blerta Deliu - Kodra, Vjosa Osmani, Alma Lama, Suzana Novoberdali dhe Albert Kinolli.

Munguan: Fatmir Limaj, Blerim Shala dhe Nekibe Kelmendi.

Emrat e Stafit Mbështetës të Komisionit: Ahtere Loxha – koordinatorë, Safet Beqiri – zyrtar për Integrime Evropiane dhe Pajtim Gashi - praktikant.

Pjesëmarrës të tjerë: Blerim Vela, Lumni Rama – përfaqësues nga OSBE-ja, Dritero Arifi – Ministria e Integrimeve Evropiane, Mimoza Gojani - Ambasada Britanike, Besnik Ramadani – KDI dhe Arban Abrashi – Kuvend.

Mbledhjen e kryesoi Lutfi Haziri – kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me Legjislacionin e BE- së;**
- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimplanit të punës së Komisionit për vitin 2011;**
- 5. Informatë nga kryetari i Komisionit për Integrime Evropiane, lidhur me vizitën në Bruksel;**
- 6. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.03.2011, nr. 1.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Integritet Evropian miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 16.03.2011 (nr. 1) pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me Legjislacionin e BE- së.

Kryesuesi konstatoi se është në kompetencë të Komisionit të shqyrtojë përputhshmërinë e Projektligjit nëse është në përputhje me legjislacionin e BE- së.

Vjosa Osmani - Tha se janë tre parime më rëndësi: parimi i pari ka të bëjë me deficitin buxhetor që sipas analizave ky buxhet arrin deficitin deri në 5.2%, ndërsa ajo që rekomandohet në vendet e BE- së dhe për ato që synojnë anëtarësim që maksimumi i lejuar është 2.7%, pra që i bije se është në kundërshtim të plotë me normat e BE- së. Parimi i dytë, si shumë i rëndësishëm, e që është përfshirë edhe në Raportin e Progresit ka të bëjë me qëndrueshmërinë fiskale, sepse ky buxhet nuk siguron një qëndrueshmëri fiskale dhe e treta ka të bëjë me nenin 4 të këtij projektligji. Kjo më shumë ka të bëjë me ligjshmërinë dhe Kushtetutën, jo domosdoshmërisht me “Acquis Communautaire”.

Xhavit Haliti - Tha se duhet të përkrahet ose jo, ky projektligj nuk mund të thuhet se është në kundërshtim të plotë, ndoshta nuk i arrin standardet e BE- së, kurse për nenin 4 Komisioni për Buxhet dhe Financa ka kaluar dy variante dhe kjo mbetet të vendoset në seancë.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Integritet Evropian një zëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me Legjislacionin e BE- së miratohet me dy rekomandimet e para të Vjosa Osmani.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimplanit të punës së Komisionit për vitin 2011

Kryesuesi - Tha se është shikuar ky draft i Planit të Punës, i cili duhet edhe më tutje, deri në javën e ardhshme, të shikohet kryesisht roli i partnerëve të Komisionit, para se të miratohet, të ftohet Ministria e Integrimeve Evropiane që të raportojë në mënyrë që të plotësohet Plani i Veprimit. Janë nxjerrë disa pika si: zgjerimi i mundshëm i bashkëpunimit me Asamblenë Parlamentare; rritja e rolit monitorues të Komisionit, jo vetëm në Ministrinë e Integrimeve Evropiane, por edhe në sektorë të tjerë që kanë të bëjnë me punën e këtij komisioni; mundësia e ndarjes në nëngrupe punuese, që secili deputet të këtë mundësi për të punuar në sektorë të veçantë; përgatitja për dialogun e stabilizimasocimit; përkrahja për ndarjen e fondeve të IPA; angazhimet konkrete ndërkomunale dhe ndërkufitare; janë propozuar disa vizita pune dhe ndarje të eksperiencave të shteteve që kanë bërë progres duke u mbështetur nga Komisioni Evropian dhe nga partnerët e tjerë, të behët një koordinim ma i mirë për kohën dhe fushat; bashkëpunimi me shoqërinë civile; bashkëpunimi me komisionet e tjera për përmbushjen e Planit të Veprimit; hartimi i një deklarate për përkushtimin dhe angazhimin e Kuvendit të Kosovës për agjendën e integrimeve evropiane.

Si përfundim u konstatua se Komisioni për Integritet Evropiane një zëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohet në parim draft - Plani i Punës dhe, në javën tjetër, mbetet të kompletohet pas raportimit të Ministrisë së Integrimeve Evropiane.

5. Informatë nga Kryetari i Komisionit për Integritet Evropiane lidhur me vizitën në Bruksel;

Kryesuesi i njoftoi anëtarët e Komisionit për vizitën në Bruksel, një vizitë e realizuar së bashku me Ministren e Integrimeve Evropiane, Vlora Çitaku, në kuadër të agjendës së Qeverisë. Vizita e cila është realizuar duke u takuar me komisionarin për Zgjerim, Stefan Füle, me komisioneren për Çështje të Brendshme, Cecilia Malmström, me Ulrike Lunacek,

raportuesen e Parlamentit Evropian për Kosovën, dhe me zyrtarë të tjerë të lartë. Qëllimi i kësaj vizite ishte “Procesi i liberalizimit të vizave” dhe qartësimi i agjendës evropiane për Kosovën në këtë proces, si shumë të rëndësishëm për vendin. Çështje e rëndësishme është cekur në këtë takim nga pesë shtete që e kanë njohur Kosovën përmes ministrave të Punëve të Brendshme, që janë shumë kritike për arritjen e standardeve dhe ne veçanti çështjet e riatdhesimit, pra zbatimin e legjislacionit. Kurse qeveria ka ndarë 3 milionë euro për këtë vit dhe 500 mijë euro i kanë mbetur nga viti i kaluar për këtë çështje. Sa i përket pesë shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën, është gjetur mekanizmi për të tejkaluar këtë problem rreth procesit të liberalizimit të vizave, si dhe është planifikuar që të ketë bashkëpunim me shumë vende të tjera, si Francën e tjera, që të arrihet sa më shpejt ky proces. Qeveria ka marrë për obligim që deri në qershor të këtij viti të realizojë disa nga detyrat që i janë paraqitur si pjesë e domosdoshme që të arrihet progres dhe që të zbatohen reformat e parapara.

Xhavit Haliti - Kërkesat për vizita jashtë vendit duhet të bëhet kërkesë për mbulimin e shpenzimeve dhe përfaqësimi të jetë i barabartë i pozitës me opozitën dhe i minoriteteve. Kërkesat që vijnë nga Qeveria duhet t'i mbulojnë shpenzimet ose nga institucionet e tjera që monitorojnë punën e Kuvendit, sepse nuk ka buxhet të mjaftueshëm për t'i mbuluar shpenzimet e ftesave të Qeverisë për udhëtime jashtë vendit.

6. Të ndryshme.

Kryesuesi i njoftoi për një kërkesë që është bërë nga ish - kryetarja e Komisionit, Zylfije Hundozi, për një trajnim të organizuar nga TAIEX- i.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Lutfi Haziri